

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-192/2015  
GSK-KPA-A-196/2015  
GSK-KPA-A-197/2015**

**Prishtinë  
17 Janar 2018**

Në çështjen juridike të:

**N. D.**

**Pala ankuese**

Kundër

**L. M.**

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje “KKPK”) KPCC/D/A/211/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA23644, KPA23640 dhe KPA23639), të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 17 Janar 2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga N. D., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-192/2015, GSK-KPA-A-196/2015 dhe GSK-KPA-A-197/2015, lidhur me lëndët e regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrat KPA23644, KPA23640 dhe KPA23639, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-192/2015.
2. Ankesat e paraqitura nga N.D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/211/2013 të datës 21 gusht 2013 lidhur me lëndët e regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrat KPA23644, KPA23640 dhe KPA23639, hedhen poshtë si të pasafatshme.

### Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 22 janar 2007, L. M.(tani e tutje “pala përgjegjëse në ankesë”), ka paraqitur disa kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP) me anë të së cilave ka kërkuar ri-posedimin e pronave të cilat gjenden në vendin e quajtur “staro selo” dhe “vise selo”, fshati Milloshevë, Komuna e Obiliqit (tani e tutje “pronat e kërkuara”). Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se humbja e posedimit mbi pronat e kërkuara ka ndodhur më 28 qershor 1999 për shkak të rrethanave të viteve 1998-1999, dhe aktualisht pronat janë të zëna nga N. D.. Përveç ri-posedimit, pala përgjegjëse në ankesë kërkon kompensim për shfrytëzimin e pronave pa pëlqimin e tij.
2. Në mbështetje të kërkesave të tij, pala përgjegjëse në ankesë i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
  - Kopjen e planit nr. 176 të lëshuar nga Departamenti i Kadastrit i Kuvendit Komunal të Prishtinës më 22 Qershor 1995, në të cilën figuron se pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të palës përgjegjëse në ankesë;
  - Fletën poseduese nr. 176 të lëshuar nga Departamenti i Kadastrit i Komunës së Prishtinës i dislokuar më 21 Dhjetor 2006, në të cilën figuron se pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të palës përgjegjëse në ankesë
3. Më 23 Dhjetor 2009, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka bërë njoftimin e kërkesës KPA23644, kurse njoftimi për kërkesën KPA23640 me 16 Nëntor 2009 dhe për kërkesën KPA23639 më 13 Nëntor 2009. Pronat e kërkuara janë gjetur të zëna nga N. D. i cili ka pretenduar interes ligjor ndaj tyre (tani e tutje “pala ankuese”).
4. Pala ankuese thekson se pronat e kërkuara i ka blerë nga vetë pala përgjegjëse në ankesë.
5. Në mbështetje të pretendimit të tij, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
  - Kontratën e shitblerjës të lidhur më 6 Shtator 2006 ndërmjet L. M. (i përfaqësuar nga avokati B. Ç.) në cilësi të shitësit të pronave të kërkuara dhe N. D. në cilësi të blerësit. Kontrata është vërtetuar në shtator 2006 dhe ka marrë numrin e referencës 773/2006;

- Ekstraktin e fletës poseduese nr. 176, të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Obiliqit më 7 shtator 2006, në të cilën figuron se pronat e kërkuara janë të regjistruara në emër të palës përgjegjëse në ankesë;
  - Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 00341 të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Obiliqit më 12 shtator 2006, në të cilën figuron se pronat e kërkuara janë azhurnuar në emër të palës ankuese.
6. Pala përgjegjëse në ankesë, përmes deklaratës së tij me shkrim të dorëzuar në AKP më 20 maj 2010, fuqishëm ka mohuar t'ia ketë shitur pronat e kërkuara palës ankuese, duke insistuar se ai asnjëherë nuk e ka nënshkruar kontratën e shitblerjes dhe se autorizimi përmes të cilit gjoja e ka autorizuar avokatin për të vepruar në emër të tij lidhur me transaksionin, është i falsifikuar.
  7. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka reaguuar lidhur me deklaratën me shkrim të palës përgjegjëse në ankesë duke e adresuar çështjen e autorizimit të falsifikuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. Kërkesës së saj, AKP-ja ia ka bashkangjitur:
    - Autorizimin e vërtetuar pranë Gjykatës Komonale të Lipjanit më 7 shkurt 2006 me numër të referencës 472/2006, përmes të cilit L. M. e ka autorizuar avokatin B. Ç. për t'ia shitur pronat e tij, t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me transferimin e të drejtave pronësore në emër të blerësit, të pranojë shumën e blerjes dhe të nxjerrë të gjitha dokumentet nga institucionet kompetente.
  8. Me kërkesë të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka nxjerrë raportin nr. AKF/2012-3169/2012-2783 të datës 11 mars 2013. Sipas raportit, nënshkrimi i L. M. në dokumentin me emrin "Autorizim" dhe mostrat e përdorura për këtë ekspertizë mund të mos jetë nënshkruar nga i njëjti person.
  9. Departamenti për Verifikim i Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së ka verifikuar pozitivisht Autorizimin nr. 472/2006 dhe Kontratën e shitblerjes nr. 773/2006, kurse Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 00341 e lëshuar nga Zyra për Kadastër e Komunës së Obiliqit është gjetur e azhurnuar në emër të palës ankuese. Ndryshimet kadastrale janë bërë në bazë të kontratës së shitblerjes nr. 773/2006 e datës 7 Shtator 2006.
  10. Më 21 Gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin e tij KPCC/D/A/211/2013 (tani e tutje "Vendimi i KKPK-së") ka vërtetuar palës përgjegjëse në ankesë të drejtën pronësore dhe të ri-posedimit mbi pronat e kërkuara dhe ka vendosur që pronat e kërkuara t'ia kthejë në posedim palës përgjegjëse në ankesë. Në arsyetimin e vendimit, KKPK-ja ka theksuar se autorizimi nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme se avokati B. Ç. është autorizuar në mënyrë të rregullt nga pala përgjegjëse në ankesë për t'i shitur pronat e kërkuara në emër të tij dhe si i tillë transaksioni i shitjes së pretenduar duhet patjetër të konsiderohet si i pavlefshëm. Nga kjo rrjedh se Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme në të cilën pala ankuese identifikohet si pronar i pronave të kërkuara është e gabuar dhe nuk mund të konsiderohet si provë për të drejtat pronësore të palës ankuese.
  11. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 24 dhjetor 2013.

12. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 10 dhjetor 2013. Pala ankuese e ka pranuar vendimin e KKPK-së personalisht, mirëpo ka refuzuar që ta nënshkruaj fletë-dërgesën. Më 18 dhjetor 2014, ai ka paraqitur ankesa kundër vendimit të KKPK-së në lidhje me kërkesat në vijim:

<b>Numri i ankesës dhe numri i lëndës në AKP</b>	<b>Informatat lidhur me ngastrën e kërkuar</b>	<b><i>Numri dhe data e vendimit</i></b>
GSK-KPA-A-192/2015 (KPA23644)	Ngastra kadastrale 305/1, tokë e kultivuar me sipërfaqe prej 3.01.81 ha, staro selo, Milloshevë	KPCC/D/A/211/2013 21 gusht 2013
GSK-KPA-A-196/2015 (KPA23640)	Ngastra kadastrale 657, pemishte me sipërfaqe prej 00.16.93 ha, staro selo, Milloshevë	KPCC/D/A/211/2013 21 gusht 2013
GSK-KPA-A-197/2015 (KPA23639)	Ngastra kadastrale 303/1, arë e klasit të VI-të me sipërfaqe prej 00.41.99 ha, staro selo, Milloshevë	KPCC/D/A/211/2013 21 gusht 2013

### **Pretendimet e palës ankuese**

13. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe të procedurës, gjithashtu bazohet në vërtetim të gabuar ose jo të plotë të fakteve.
14. Pala ankuese pretendon se është ftuar nga KKPK-ja më 15 dhjetor 2014 dhe në prani të avokatit të tij është njoftuar se gjoja ka refuzuar pranimin e vendimit të KKPK-së. Pala ankuese ka shtuar se sipas shkresave të lëndës provat i janë dorëzuar atij, vendimet e KKPK-së më 10 dhjetor 2013. Pala ankuese ka deklaruar se asnjëherë nuk i ka pranuar vendimet e KKPK-së; prandaj, nuk ka pasur asnjë mundësi dhe asnjë arsye që t'i refuzojë ato. Sipas palës ankuese, ai ka paraqitur ankesë pas pranimit të vendimit të KKPK-së përmes avokatit të tij.
15. Pala ankuese e kundërshton fuqishëm vendimin e KKPK-së duke theksuar se i ka blerë pronat e kërkuara, ky fakt mund të vërtetohet me kontratën e shitblerjes e cila është vërtetuar në Gjykatën Komonale të Prishtinës.
16. Sipas palës ankuese, kundër avokatit të tij B.Ç. dhe personave të tjerë është duke u zhvilluar procedurë penale në bazë të aktakuzës PP.nr. 319-8/11 së Prokurorisë Komonale të datës 3 Mars 2012, prandaj, KKPK-ja nuk ka pasur të drejtë të marrë vendim derisa procedura penale të arrijë në fazën e saj përfundimtare.

**Arsyetimi ligjor****Bashkimi i ankesave:**

17. Sipas nenit 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Gjykata Supreme e Kosovës mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të Ligjit. Ky nen ia lejon Komisionit që të marrë parasysh bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit të tyre dhe marrjes së vendimeve lidhur me to kur ka çështje të përbashkëta dhe të qarta ligjore që duhet shqyrtuar.
18. Dispozitat e Ligjit mbi procedurën civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozitat e nenit 408.1 në lidhje me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi procedurën kontestimore, e përcaktojmë mundësinë e bashkimit të të gjitha kërkesave përmes aktgjykimit, nëse një gjë e tillë do të sigurojë efektivitetin dhe efikasitetin e lëndës.
19. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën është paraqitur ankesa përkatëse, faktet, arsyet ligjore dhe çështjet e provave janë saktësisht të njëjta në gjashtë lëndët. Vetëm ngastrat kadastrale, objekt i së drejtë pronësore e cila kërkohet në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në të njëjtin dokumentacion. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat mbetet i njëjtë.
20. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-12/2015, GSK-KPA-A-196/2015, dhe GSK-KPA-A-197/2015, bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-192/2015.

**Pranueshmëria e ankesës**

21. Ankesa është e paafatshme.
22. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës i ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka gjetur dy (2) fletë-dërgesa në të cilat figuron se vendimet e KKPK-së i janë dërguar palës ankuese dy herë. Herën e parë, më 10 dhjetor 2013. Pala ankuese e ka pranuar vendimin, mirëpo ka refuzuar që ta nënshkruaj fletë-dërgesën. Herën e dytë, vendimi i është dorëzuar më 28 tetor 2014. Vendimi është pranuar nga djali i palës ankuese, L.D.
23. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.*

24. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese për herë të parë më 10 dhjetor 2013 dhe për herën e dytë më 28 tetor 2014. Pra, afati për të paraqitur ankesë ka skaduar më 13 janar 2014 ose më 29 nëntor 2014, nëse gjykata do ta pranonte pranimin e fundit si të vlefshëm. Megjithatë, pala ankuese e ka paraqitur ankesën e tij më 18 dhjetor 2014, gati 1 (një) vit pasi e ka pranuar vendimin për herë të parë dhe 2 muaj pasi djali i tij i ka pranuar vendimet. Kjo është jashtë afatit kohor.
25. Edhe pse, pala ankuese ka qenë vazhdimisht aktiv gjatë procedurës në shkallën e parë, ai pretendon se asnjëherë nuk i ka pranuar vendimet e KKPK-së përndryshe ai nuk ka interes ligjor që ta refuzojë nënshkrimin e fletë dërgesave dhe pranimin e vendimit.
26. Neni 6.3 në lidhje me nenin 6.5 (b) të Urdhërësës Administrative 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 përcakton se: *“Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës sigurohet që dërgesa të bëhet në adresën për kryerjen e dërgesave të asaj pale, qoftë duke e dërguar kopjen e dokumentit përmes postës zyrtare, e cila jep vërtetimin, apo përmes dorëzimit personal të kopjes, për të cilin po ashtu merret vërtetimi për dorëzimin e dokumentit. Në rast të dërgimit personal të dokumentit, nëse pala pranuese ka refuzuar pranimin e dokumentit apo nënshkrimin e vërtetimit për pranim, në ditën kur shërbimi është tentuar të kryhet, personi që e dorëzon dokumentin e shënon se dokumenti nuk është pranuar dhe kthehet në Sekretarinë Ekzekutive”*.
27. Në këtë rast, zyrtari i Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së ka shënuar se pala ankuese e ka pranuar vendimin e KKPK-së, mirëpo ka refuzuar që ta nënshkruaj pranimin me 10 Dhjetor 2013. Mbi këtë bazë dhe bazuar në sqarimet e mësipërme Gjykata Supreme konsideron se dorëzimi me 10 Dhjetor 2013 ka qenë i ligjshëm edhe sipas përcaktimeve të nenit 212 të Ligjit nr. 03/L006 mbi procedurën kontestimore që parasheh se nëse përmbushen kushtet *“Komunikimi i kryer në këtë mënyrë qubet i ligjshëm”*.
28. Lidhur me pretendimin e palës ankuese se vendimin e KKPK-së e ka pranuar përmes avokatit të tij, Gjykata Supreme është e mendimit se pretendimi i tillë nuk qëndron.
29. Në përputhje me nenin 5.3 të Urdhërësës Administrative 2007/5 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, *avokati që vepron në emër të palës duhet t’ia dorëzojë Sekretarisë ekzekutive apo Zyrës së regjistrimit të Gjykatës Supreme një kopje të autorizimit, e cila ia jep autorizimin për përfaqësim të asaj pale në procedurën para Komisionit apo para Gjykatës Supreme*.
30. Nga shkresat e lëndës është e qartë se pala ankuese asnjëherë nuk ka angazhuar avokat për të vepruar në emër të tij as gjatë procedurës në shkallën e parë e as gjatë fazës së apelit. Nuk ka absolutisht asnjë autorizim të bashkangjitur as në shkresat e lëndës e as në ankesë.
31. Gjykata Supreme nuk do t’i shqyrtojë pretendimet tjera të palës ankuese për jo për shkak të relevantes së tyre por për faktin se ankesa është e vonuar dhe se bazuar në nenin 195.1 parasheh shprehimisht se Gjykata e ankimit, në seancën e kolegjit *“hedhë poshtë ankesën si të vonuar”*.
32. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë për arsye procedurale si e paafatshme në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafin (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1 (a) dhe 196 të Ligjit mbi procedurën kontestimore nr. 03/L-006.

### **Këshillë juridike**

Në përputhje me nenin 13.6 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

*Beshir Islami, kryetar i kolegjit*

*Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it*

*Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtar*

*Bjorn Olof Brautigam, ushtrues i detyrës së referentit të EULEX-it*